



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:106928

Datë: 25.10.2023

Numri i dokumentit: 04826328

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.402/21

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnje në çështjen penale kundër të pandehurit A. B. nga Peja, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.898/21 të datës 18.06.2021 për shkak të veprave penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së si dhe Kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 23.10.2023 në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij të autorizuar av.Rrustem Lajqi nga Peja, të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 24.10.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

A. B. , i lindur me, në Pejë, ku dhe jeton Lagja. – Sh., rr.Xh. H. – pa nr. i biri i R. dhe R., e gjinisë Gj., i martuar baba i d fëmijëve, ka të kryera pesë klasë të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër..... – lëshuar nga MPB R-Kosovës, posedon telefon me nr.049/...-..., Egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

I. Me datë 20.05.2021 rreth orës 10:30 në st. policor në Pejë , me qëllim të frikësimit seriozisht me fjalë e kanos personin tjetër se do t'i shkaktojë ndonjë të keqe dhe atë të dëmtuarin E. E. , në atë mënyrë që derisa i dëmtuari E.në zyrën e stacionit policor ishte duke u intervistuar në cilësinë e dëshmitarit nga zyrtari policor F. M., i pandehuri A. nga korridori i drejtohet të njëjtit

me fjalë kërcënuese “ *Unë me këta merrna ,duke aluduar në të dëmtuarin ,merrna kur të dal jashtë* “me çka tek i dëmtuari shkakton frikë,

- me çka ka kryer veprë penale “Kanosja” nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

II. Me dt. 20.05.2021 rreth orës 10:30 në Stacionin Policor në Pejë , seriozisht me fjalë e kanos personin zyrtar në lidhje me punën e tij se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe dhe atë të dëmtuarin/policin F. M. , në atë mënyrë që ditën kritike derisa i dëmtuari F. ishte duke e intervistuar të dëmtuarin E. sipas dispozitivit të parë ,i pandehuri A. fillimisht i kanoset të dëmtuarit E. për çka i dëmtuari F. tenton që ta qetësoj duke e njoftuar se ato fjalë paraqesin kërcënim më pas i pandehuri i drejtohet këtij të fundit me fjalët ”*E sheh ti se kush jam unë dhe se kur të del ti prej prej ktuhit ki me pa se kush jam unë* “

-me çka ka kryer veprë penale “Kanosja” nga neni 181 par. 3 lidhur par. 1 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

- Të pandehurit A. B. i shqipton:

Për veprën penale si ne pikën I. te aktgjykimit, DËNIM ME BURGIM ne kohëzgjatje prej 90 ditësh.

Për veprën penale si ne pikën II. të aktgjykimit, DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 viti.

- Për veprën penale si në pikën I. dhe II të aktgjykimit i shqiptohet dënimi unik, DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje 14 muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Obligohet i dënuari qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

ARSYETIM

Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 18.06.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.898/21 kundër të pandehurit A. B. për shkak të veprave penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së si dhe Kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 23.10.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij të autorizuar av.Rrustem Lajqi nga Peja, në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështetin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi “Pajtohem me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të akuzuarit A. B. për veprat penale për të cilat i vihet në barrë, meqenëse një pranim të tillë e bëri në mënyrë vullnetare dhe në mbështetje të fakteve të çështjes që përmban aktakuza, andaj duke u bazuar në këto rrethana kërkoj që ky pranim fajësie të aprovohet si i tillë”.

Mbrojtësi i të pandehurit deklaroi " Pasi që u aprovua pranimi i fajësisë nga ana e gjykatës kërkoj që ky pranim fajësie të merret si rrethanë posaçërisht lehtësuese, gjendjen e varfër ekonomike dhe konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin tim dhe bindshëm deklaron se kurrë më parë nuk ka kryer vepra penale, nuk e di se nga kanë derivuar këto të dhëna, kjo vepër ka ndodhë që dy vjet dhe nuk ka pas problem me ata persona me të cilët praktikisht është pajtuar, kërkoj nga gjykata të shqiptoj një dënim sa më të lehtë, sa më të butë me të cilin do të arrihej efekti i dënimit".

Pas pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës i pandehuri deklaroi " unë kërkoj falje shumë që e kam bërë këtë vepër, unë atë ditë kam shkuar me dhonë deklaratë që mi kanë vjedh sendet atë ditë dhe masandej ka eskaluar situata dhe unë i kam fol ato fjalë për të cilat më vjen shumë keq".

Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49 ,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë ose dënim me burgim deri në gjashtë muaj, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh.

Për veprën penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë ose dënim me burgim deri në gjashtë muaj, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh.

Për veprën penale Kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj deri në 5 vite burgim, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti.

Në kuptim të nenit 76 të KPRK-së, gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënim unik me burgim të kushtëzuar, në kohëzgjatje prej 14 muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale, brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh, i cili dënim do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe

42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit A. B. , do të arrihet të realizohet në tërësi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin me kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua me lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 369 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.402/21, me datë 24.10.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnye

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.